



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar
Tiranë, më 11.12. 2018

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PER DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9049, DATË 10.4.2003 “PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, TË NDRYSHUAR

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (komisioni-këtej e tutje) në cilësinë e komisionit përgjegjës , në mbledhjen e datës 11.12.2018 mori në shqyrtim projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 *"Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike"*, të ndryshuar, nismë e deputetes Klotilda Bushka (Ferhati). Komisioni caktoi relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Vasilika Hysi.

Në mbledhjet e Komisionit për të diskutuar dhe paraqitur propozime për projektligjin ishin të pranishëm, përfaqësuesit e Inspektoriatit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurisë, z.Flori Karaj dhe znj.Evgjeni Bashari, eksperti i Misionit Euralius, Gianluigi Pratola, si dhe përfaqësues të USAID.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozim deputeti dhe është depozituar sipas përcaktimeve të nenit 81, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe shoqërohet me relacionin përkatës që përmbush kërkesat e parashikuara nga neni 68 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT E TIJ

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) është një institucion i rëndësishëm në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, të abuzimit me detyrën dhe parandalimin e konfliktit të interesit.

Roli i këtij institucioni është rritur edhe më shumë për shkak të përgjegjësive që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka parashikuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë dhe të përgjegjësive të reja në kuadër të ligjit “Për sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Progres Raporti i Bashkimit Evropian për Shqipërinë, i publikuar në Prill 2018 nënvizon se:

“Roli i ILDKPK-së në zbulimin e konflikteve të interesit dhe kontrollimit të deklaratave të pasurisë u forcua me miratimin e Ligjit për mbrojtjen e bilbilffryrëse dhe mbrojtjen e bilbilffryrësit dhe me zbatimin e Ligjit për procesin e rivlerësimit kalimtar. Kjo e fundit parashikon që gjyqtarët, prokurorët dhe këshilltarët ligjorë i nënshtrohen verifikimit. Numri i inspektorëve në HIDAACI u rrit nga 20 në 28. Kapaciteti i tij administrativ, teknik dhe financiar duhet të forcohet më tej për të përballuar kontrollin e deklaratës së aseteve. Një sistem i deklarimit të aseteve online ende nuk është krijuar¹.

Projektligji në diskutim përmbush detyrimin e marrë nën Prioritetin 3 “Lufta kundër Korrupsionit”, si pjesë e udhërrëfyesit për 5 prioritetet kyçe për integrimin evropian të vendit, si dhe në dritën e rekomandimeve të shumta të instrumenteve dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë.

GRECO në Korrik të vitit 2018 ka nxjerrë raportin e tij të dytë të përputhshmërisë në Shqipëri “Parandalimi i krimit në lidhje me anëtarët e parlamentit, gjyqtarët dhe prokurorët”. Në raportin e mëparshëm, GRECO kishte rekomanduar që përmbajtja e deklaratave të pasurive të anëtarëve të parlamentit të bëhen publike në një faqe zyrtare dhe në kohën e duhur, duke marrë parasysh respektimin e privatësisë dhe sigurisë së deputetëve dhe personave të lidhur me ata që janë subjekt i një detyrimi për raportim². Falë ndryshimeve të kryera ligjin nr. 42/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, detyrimet financiare të të zgjedhurve dhe disa punonjësve publikë” GRECO- s nënvizon se:

“Rekomandimi është përmbushur në mënyrë të kënaqshme nga Shqipëria. ... Gjithsesi mbetet akoma punë për tu bërë përsa i përket krijimit të sistemit online ku do të lejohet hedhja dhe menaxhimi elektronik i këtyre të dhënave.³

¹ Albania 2018 Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2018 Communication on EU Enlargement Policy <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>, Faqe 23

² Raporti I GRECO “Parandalimi i krimit në lidhje me anëtarët e parlamentit, gjyqtarët dhe prokurorët”, Korrik 2018, Rekomandimi V, paragrafi 31, faqe 8.

³ Po aty, paragrafi 37, faqe 8.

Gjithashtu, rekomandimi tjetër i bërë prej GRECO-s konsiston në kontrollin më të shpeshtë të deklarimit të pasurive nga të deputetëve dhe rritjes së bashkëpunimit ndërmjet Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe institucioneve përkatëse shtetërore⁴. Përsa i përket rekomandimit për kontrollin GRECO shprehet:

Që e konsideron të përmbushur komplet pasi ndryshimet në ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa punonjësve publikë” intervali për kryerjen e kontrollit të plotë të deklaratave të pasurive të deputetëve është reduktuar në dy vjet. Ndërsa përsa i përket rekomandimit të dytë për rritjen e bashkëpunimit mes ILDPKI dhe institucioneve të tjera shtetërore shprehet se është realizuar në mënyrë të kënaqshme.⁵

Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020 dhe Plani i saj i Veprimit, në një nga objektivat (Objektivi A5), parashikon specifikisht:

“Forcimin e regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave nëpërmjet mundësimit të deklarimeve online të pasurisë për të gjithë subjektet deklaruese, si dhe publikimin e deklaratave të interesave private pa kërkesë, si faktorë që kontribuojnë në kufizimin e korrupsionit”.

Problemi i ngritjes së sistemit online të deklarimit është adresuar edhe nga Kuvendi i Shqipërisë. Në Rezolutën “Për vlerësimin e punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2017” janë lënë si prioritet për vitin 2018:

“Vazhdimin e ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile. Forcimin e mëtejshëm të urave të bashkëpunimit me median investigative. Respektimi i mekanizmave informues ligjorë e publikë, duke respektuar ligjin për të drejtën e informimit dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale, për publikimin e deklaratave të interesave private”, si dhe angazhimin e Kuvendit dhe të Qeverisë për të mbështetur institucionin me financime të nevojshme për sigurimin e qendrueshmërisë së sistemit elektronik, të deklarimit të interesave private.

Me gjithë përmirësimet e veprimtarisë për periudhën 2014-2017 dhe vlerësimet nga partnerë vendas e ndërkombëtarë, ILDKPI vazhdon përpjekjet për përmirësimin e mëtejshëm të teknikave dhe metodikave investiguese në përmbushje të misionit institucional, veçanërisht atij të deklarimit dhe kontrollit të pasurive.

Neni 4/2 dhe neni 34 i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, i hap rrugën mundësisë së plotësimit dhe depozitimit të deklaratave elektronikisht, me qëllim jo vetëm modernizimin e sistemit të deklarimit të pasurisë, por edhe rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të kryerjes të kontrollit të deklaratave të interesave private për subjektet deklarues. Në këtë kuadër, ILDKPI filloi zbatimin e dy projekteve për asistencë

⁴ Po aty, paragrafi 39, faqe 9.

⁵ Po aty, paragrafi 43, faqe 9.

teknike dhe financiare me mbështetjen e Agjensisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian.

Sikurse thuhet në relacionin që shoqëron projektligjin *“Aktualisht, ILDKPKI është duke punuar dhe koordinuar proceset ndërmjet të dy donatorëve kryesor USAID/Këshilli i Evropës, në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale lidhur me asistencën e dhënë në ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit të interesave private, të cilët pritet të dorëzojnë produktet e tyre brenda muajin mars 2019.*

Në këtë kuadër, është e rëndësishme të theksohet fakti se ngritja dhe vënia në funksionim e sistemit elektronik të deklarimit të interesave private vjen jo vetëm si një domosdoshmëri e ILDKPKI për të përmbushur detyrimeve ligjore, në rritjen e efikasitetit në plotësimin, administrimin, kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik, si dhe publikimin e të dhënave në deklaratat e interesave private për konsultim nga publiku dhe palë të tjera të interesuara, por dhe si një angazhim i marrë përkundrejtë partnerëve ndërkombëtarë.

Sa më sipër, projektligji *“Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”* i ndryshuar, vjen si domosdoshmëri e përsosjes së mëtejshme të kuadrit ligjor aktual për të lehtësuar procesin e ngritjes dhe vënies në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit të interesave private, si një mekanizëm i rëndësishëm në forcimin e mjeteve investiguese/kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, me impakt të ndjeshëm jo vetëm në luftën kundër korrupsionit në të gjitha kategoritë e zyrtarëve, të cilët kryejnë funksione publike, por edhe në përmbushjen e pritshmërisë qytetare në rritjen e efektivitetit në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit të zyrtarët që ushtrojnë funksione publike.

III RISITË E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i depozituar rregullon dhe përmirëson ligjin ekzistues për çështje që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit të interesave private. Në mënyrë të përmbledhur nisma e depozituar sjell risitë e mëposhtme:

1 Qartësimi i detyrimit që mbartin subjektet aktuale, të cilët kanë plotësuar dhe dorëzuar më parë deklarata të interesave private, në rast se vendosin të kandidojnë për një vend në organet e drejtësisë. Në mënyrë të qartë ky ndryshim parashikon se këta subjekte nuk kanë detyrim për të plotësuar “deklaratën e interesave private për kandidat në institucionet e sistemit të drejtësisë”, por në momentin e kandidimit do t’i nënshtrohet kontrollit të plotë, duke dalë nga skema e parashikuar nga neni 25/1 i ligjit.

2 Qartësimi i mënyrës së dorëzimit të deklarave të interesave private me ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit elektronik (online) të deklarimit të interesave private. Me vendosjen në funksionim të sistemit, përparësi do të ketë mënyra e dorëzimit me anë të mjeteve elektronike dhe vetëm në përfundim të procesit të plotësimit dhe ruajtjes, nëpërmjet

këtij sistemi, subjektet që mbartin detyrimin për deklarim do të printojnë dhe dorëzojnë në formë shkresore, pranë strukturave përkatëse, kopjen e deklaratës së interesave private.

3 Krijimi i mundësisë që inspektorët e autorizuar nga Inspektori i Përgjithshëm, t'i adresojnë kërkesë bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera, që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, për të marrë të dhëna lidhur me depozitat, llogaritë dhe transaksionet e kryera nga personat që, sipas këtij ligji, kanë detyrimin për deklarim. Ndryshimi i parashikuar i hap rrugë institucioneve private për të mos pasur asnjë pengesë ligjore lidhur me komunikimin dhe ndërveprimin, në mënyrë të drejtpërdrejtë, me inspektorët e autorizuar nga Inspektori i Përgjithshëm për ushtrimin e kontrolleve ose hetimeve administrative.

4 Hiqen afatet e mëparshme 3 dhe 5 vjeçare të parashikuara për vënien në funksionim të sistemit elektronik (online) të deklarimit të interesave private, në kushtet kur Inspektorati i Lartë është drejt përmbushjes së detyrimeve të marra përkundrejt partnerëve ndërkombëtarë USAID/Këshilli i Evropës/BE përgjatë vitit 2019. Shfuqizimi i afateve strikte 3 dhe 5 vjeçare do t'i hapë rrugën Inspektoratit të Lartë që me marrjen në dorëzim të sistemit elektronik (online) të deklarimit të interesave private, të fillojë në mënyrë të menjëhershme fazat e pilotimit, testimit, trajnimit dhe finalizimit të procesit për të gjithë subjektet që mbartin detyrimin për deklarim.

5 Hapet rruga ligjore për plotësimin për herë të parë të deklaratës së interesave private nga subjektet që mbartin detyrimin për deklarim nëpërmjet sistemit të deklarimit me anë të mjeteve elektronike, duke parashikuar detyrimin e tyre për të dhënë:

- a) në deklaratën periodike të vitit të parë të deklarimit me anë të sistemit elektronik (online) gjendjen e pasurisë së grumbulluar, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë burimet e krijimit të tyre, në 31 dhjetor të vitit të deklarimit;
- b) në deklaratën para fillimit të detyrës, gjendjen e pasurisë së grumbulluar, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë burimet e krijimit të tyre, në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit;
- c) në deklaratën pas largimit nga funksioni gjendjen e pasurisë së grumbulluar, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë burimet e krijimit të tyre, në datën e largimit nga funksioni.

Projektligji u konsultua dhe me misionin Euralius, që në opinionin me shkrim dërguar Komisionit, rekomandon që:

Projektligji përfshin vetëm ndryshime, të mirëpritura nga EURALIUS dhe Projekti Antikorrupsion i Binjakëzimit të BE-së, me qëllim të zgjidhjes së disa problemeve në standardet e teknikës legjislative, në organizimin e procedurës së kontrollit dhe në lidhje me bërjen efektiv sa më shpejt të sistemit elektronik të deklarimit të pasurisë.

Pavarësisht nga sa më sipër, Komisioni për Çështjet Ligjore duhet të marrë në konsideratë edhe çështje të tjera të ngritura në raportet e mëparshme të organizatave ndërkombëtare si

GRECO, Raportet e Progresit të BE-së, Money Val-it, lidhur me ligjin nr. 9049, dhe të adresojë problemet përkatëse.

Komisioni për Çështjet Ligjore mund të marrë në konsideratë dhe dhënien e kompetencave ILDKL-së për të kryer “hetime të ngjashme të policisë gjyqësore”, pa u mbivendosur me kompetencat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

Së fundi, Komisioni të shqyrtojë mundësinë për të propozuar amendamente, të cilat forcojnë më tej koordinimin / bashkëpunimin ndërmjet subjekteve publike dhe private për mbledhjen dhe analizimin e informacionit në lidhje me fshehjen e pasurive dhe interesave private.

IV. ÇËSHTJET E DISKUTUARA NË KOMISION DHE NDRYSHIMET E PROPOZUARA

Nisma u diskutua në grup pune së bashku me relatoren. Projekti i propozuar ka pësuar disa ndryshime dhe përmirësime.

Përmirësimet, shtesat dhe ndryshimet përmbledhen si më poshtë:

1. Shmangia e referencave në nenet përkatëse të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, pasi ky ligj duke u nisur nga rekomandimet e ekspertëve të BE-së dhe KiE, së shpejti do të rishikohet. Referimi bëhet në legjislacionin në fuqi sipas fushës përkatëse të veprimit, pa referencë në nenet përkatëse, duke shmangur nevojën e rishikimit të këtij ligji sa herë që ligji i fushës së veprimit ndryshon.
2. Parashikimi i një mekanizmi zhblllokimi për zgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm, duke iu referuar frymës dhe ligjeve të reformës në drejtësi për zgjedhjen e titullarëve të institucioneve, aq më tepër kur nuk ka zëvendës titullarë, siç është dhe në rastin konkret, dhe kur vazhdimi në detyrë, derisa të zgjidhet pasardhësi, nuk është parashikuar shprehimisht në ligj.
3. Zgjidhje e problematikave që mund të krijohen nga mospërputhja e të dhënave në deklarin e mëparshëm me ato të plotësuara në sistemin *on line*.

Përmirësimet nen për nen janë si më poshtë vijon:

Sqarime për tekstin integral:

Neni 1 nuk ndryshon nga versioni në nismën e depozituar, përveç se ka riformulime për efekt të teknikës legjislative përsa i përket referimeve në legjislacionin e posaçëm në fuqi.

Neni 2 është i njëjtë me nismën e depozituar;

Neni 3, ka një ndryshim të togfjalëshit “formë fizike” që zëvendësohet me togfjalëshin “formë shkresore”;

Pas nenit 3 shtohet një nen i ri i cili rregullon nenin 7 të ligjit në fuqi që bën riformulime për efekt të teknikës legjislative përsa i përket referimeve në legjislacionin e posaçëm në fuqi.

Shtohet një nen i ri që rregullon nenin 9 të ligjit në fuqi, që bën riformulime për efekt të teknikës legislative për sa u përket referimeve në legjislacionin e posaçëm në fuqi.

Shtohet një nen i ri që ndryshon nenin 11. Rishikimi i tij është sugjeruar të shtohet, duke iu referuar frymës dhe ligjeve të reformës në drejtësi sipas të cilës ligji duhet të parashikojë mekanizma zhbllokimi, kur bëhet fjalë për zgjedhjen e titullarëve të institucioneve, aq më tepër kur institucioni nuk ka zëvendës titullarë, siç është dhe në rastin konkret dhe kur vazhdimi në detyrë derisa të zgjidhet pasardhësi nuk është parashikuar shprehimisht në ligj. Inspektori i Përgjithshëm zgjidhet për një mandat 7 vjeçar.

Në komision pati diskutime lidhur me të drejtën e rizgjedhjes së Inspektorit. Një pjesë e deputetëve u shprehen që të sanksionohej shprehimisht në ligj se Inspektori i Përgjithshëm të zgjidhet me mandat 7 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Argumentet e sjella ishin se duhet të ketë një rregullim standard për të gjithë drejtuesit e institucioneve të pavaruara kushtetuese ose të krijuar me ligj, si Guvernatori i Bankës, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, etj.

Në ligjin aktual, në nenin 11, parashikohet se Inspektori i Përgjithshëm zgjidhet me 3/5 e gjithë anëtarëve të Kuvendit për një mandat 7-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.” Në nenin e propozuar parashikohet se : “Inspektori i Përgjithshëm zgjidhet nga Kuvendi për një mandat 7- vjeçar.”

Komisioni vendosi që të mos pranojë shtesën e togfjalëshit “me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë”, propozuar nga deputetët, sepse formulimi në nenin që propozohet është i qartë, për sa parashikohet një mandat 7-vjeçar.

Numri i kandidatëve që i paraqiten për votim Kuvendit është jo më pak se dy kandidatë dhe votimi i tyre është me 3/5 e anëtarëve të Kuvendit. Në rastin kur asnjë kandidat nuk merr shumicën e votave të kërkuara nga ligji, Kuvendi zhvillon një votim të dytë, jo më vonë sesa 7 ditë nga përfundimi i raundit të parë të votimit. Në raundin e dytë, Inspektori i Përgjithshëm zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Ky mekanizëm zhbllokues është konsultuar dhe me ekspertë të Misionit Euralius, të cilët kanë rekomanduar zgjedhje të ngjashme me ato të parashikuara në legjislacionin për organet e sistemit të drejtësisë.

Në këtë nen parashikohet edhe institucioni ku Inspektori dorëzon deklaratën e parë të pasurisë që do të jetë Kuvendi i Shqipërisë, sikurse veprohet edhe me institucionet e tjera që zgjidhen nga Kuvendi.

Në këtë nen është parashikuar gjithashtu që pas përfundimit të mandatit, me pëlqimin e tij, Inspektori i Përgjithshëm ka të drejtë të emërohet në funksionin ose detyrën publike që kishte para zgjedhjes së tij ose në një vend të barasvlefshëm me vendin e mëparshëm. Ai nuk përfiton nga kjo e drejtë, në rastet kur shkarkohet për shkelje të rëndë të ligjit ose për akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitëndhe figurën e Inspektorit të Përgjithshëm.

Shtohen dy nene të reja që rregullojnë referencat ligjore në nenin 15 dhe 17 të ligjit në fuqi.

Shtohet një nen i ri i cili rregullon referencat ligjore në nenin 25/1 të ligjit në fuqi si dhe saktëson se afati i kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë dhe interesave private mund të zgjatet në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 4 i projektligjit është riformuluar për efekt të teknikës legislative.

Shtohet një nen i ri pas nenit 4 të projektligjit, që rregullon referencat ligjore në nenin 40 të ligjit në fuqi.

Në nenin 5 të projektligjit shtohet edhe një ndryshim i pikës 7 të nenit 42/1. Pra hiqet shprehja «pa të drejtë rizgjedhjeje» duke përshtatur përmbajtjen e tij me nenet e ndryshuara, konkretisht me nenin që ndryshon nenin 11 të ligjit në fuqi.

Neni 6 i projektligjit mbetet njësoj si në versionin e nismës së depozituar.

Pas nenit 6 të nismës së depozituar shtohet një nen i ri i emërtuar “dispozita kalimtare” që rregullon mënyrën e trajtimit të mospërputhjes midis të dhënave të sistemit të ri *on line* me ato të deklaruara më parë. Ky është një tjetër formulim që është konsultuar me ekspertët e misionit Euralius. Nëse të dhënat e plotësuara në dy sistemet e raportimit nuk përkojnë, dhe lind nevoja e verifikimeve, sipas frymës së ligjit në fuqi të dhënat konsiderohen të sakta nëse vërtetohen/justifikohen sipas përcaktimeve në ligj. Prandaj mospërputhjet duhen vlerësuar në këtë frymë, e nuk mund të jenë shkak për penalizim apo të konsiderohen në disfavor të subjektit deklarues.

Neni 7 i projektligjit mbetet i njëjtë me versionin e nismës së depozituar. Ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për shkak të shtesave dhe ndryshimeve të bëra në projektligjin e depozituar, nenet e projektligjit rinumërohen dhe seancës plenare i kalon për votim varianti integral i projektligjit.

V. PËRFUNDIME

Nga pikëpamja kushtetuese, projektligji është hartuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe propozon disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë*”, të ndryshuar. Referuar ndryshimeve të pritshme për t’u miratuar në këtë projektligj, nuk ka efekte financiare të planifikuara.

Nga pikëpamja e përmbajtjes, projektligji është në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Strategjinë Sektoriale ku në pjesën e 8 “Themelet: Qeverisja e mirë, Demokracia dhe Shteti i së Drejtës” në pikën 8.9 “Transparenca dhe lufta kundër korrupsionit” në objektivat strategjike përfshihen: “1. Parandalimi i korrupsionit dhe rritja e besimit të publikut nëpërmjet: 1.8 forcimit të regjimit të deklarimit dhe kontrollit të

pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konflikteve të interesit, nëpërmjet një sistemi online të deklarimit për të gjitha subjektet raportuese dhe mundësinë e publikimit të tyre, veçanërisht për personat në nivele të larta drejtuese dhe të zgjedhurit. 2. Parandalimi i korrupsionit me anë të përmirësimit të procedurave të administratës publike, në veçanti, nëpërmjet: 2.1 forcimit të infrastrukturës elektronike të institucioneve publike dhe automatizimit të proceseve mbështetëse; 3. Ndëshkimi i korrupsionit dhe ulja e pandëshkueshmërisë nëpërmjet: 3.1 efektivitetit më të madh të hetimeve penale kundër krimeve ekonomike dhe financiare, sidomos në fushën e hetimeve parandaluese dhe pasurimit të paligjshëm; 3.2 përmirësimit të bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese, me qëllim procedimin dhe ndëshkrimin e rasteve të korrupsionit, me anë të menaxhimit dhe shkëmbimit të informacionit”.

Projektligji është në përputhje të plotë me vetë Deklaratën e prioriteve të Qeverisë, ku prioriteti i parë kërkon “(1) shërbime publike inovatore, që kanë në qendër qytetarin (qeverisja e mirë)”, çka përputhet plotësisht me shërbimet që do të ofrohen nëpërmjet ngritjes dhe vënien në funksionim të sistemit online të deklarimit të pasurive.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se :

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, sipas propozimeve, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm miratoi projektligjin sipas tekstit integral bashkëlidhur këtij raporti.

RELATORE

VASILIKA HYSI

KRYETAR

ULSI MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI
PROJEKTLIGJ
Nr._____/2018**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9049, DATË 10.4.2003
“PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE
FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË” TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2, pikat 4, 8 dhe 9 ndryshohen si më poshtë:

“4. “Person i lidhur me një zyrtar” ka kuptimin e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

8. Termat “konflikt i interesit”, “zyrtar”, “person i lidhur”, “interesa privatë”, të përdorur në këtë ligj, kanë kuptimin e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

9. Përkufizimet “të dhënat personale” dhe “përpunimi i të dhënave” kanë kuptimin e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 2

Në nenin 3/1, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kandidatët për pozicionet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, që janë subjekte që mbartin detyrimin për deklarimin e interesave privatë, sipas parashikimeve të nenit 3, të këtij ligji, nuk kryejnë një deklaram të ri, por i nënshtrohen kontrollit të plotë të pasurisë. Nëse gjatë 180 ditëve para paraqitjes së kërkesës, kandidati është kontrolluar nga Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe kontrolli nuk ka rezultuar në disfavor të tij, atëherë kontrolli konsiderohet i kryer”.

Neni 3

Në nenin 4/2, pikat 1 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“1. Të gjitha subjektet e ligjit dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrim për deklaram, detyrohen të plotësojnë deklaratën e tyre në formë elektronike me mjetet e komunikimit elektronik, të vëna në dispozicion nga Inspektorati i Lartë dhe ta paraqesin personalisht, në formë shkresore, të mbyllur në zarf në strukturat përkatëse të institucioneve, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj për të gjitha llojet e deklaramit.

3. Deklarata e dërguar me mjete të komunikimit elektronik konsiderohet e marrë me plotësimin dhe dërgimin në sistemin e deklaramit me mjetet elektronike”.

Neni 4

Në nenin 7, pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

“3. Të gjithë zyrtarët dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrim për deklaram, detyrohen të paraqesin deklaratën e tyre deri më 31 mars të çdo viti, pranë autoritetit ose strukturës përgjegjëse të institucionit publik, të parashikuar në legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

4. Kur zyrtari transferon të drejtat e zotërimit aktiv të aksioneve ose të pjesëve në kapital, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, në deklarimin periodik, për sa kohë vazhdon kjo gjendje, ai deklaron vetëm gjendjen e këtyre të drejtave para transferimit dhe frytet e pasurisë, të cilat ai ka marrë efektivisht gjatë vitit për të cilin bëhet deklarimi”.

Neni 5

Në nenin 9, pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Vlerësohet person i lidhur, në zbatim të pikës 1 të këtij neni, edhe i besuari, sipas kuptimit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, si dhe bashkëjetuesi, sipas kuptimit të përcaktuar nga Kodi i Familjes.

3. Inspektori i Përgjithshëm, për efekt të verifikimit të deklarimit të të ardhurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat, i dërgon ministrit përgjegjës për financat dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve informacion për listën e individëve, të cilët kanë rezultuar persona të lidhur me subjektet deklaruese që mbartin detyrim për deklarim, sipas pikës 1 të këtij neni.”

Neni 6

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

Inspektori i Përgjithshëm

1. Organi përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive është Inspektori i Përgjithshëm.
2. Inspektori i Përgjithshëm zgjidhet nga Kuvendi për një mandat 7- vjeçar.
3. Kuvendi i Shqipërisë, jo më vonë se tre muaj, përpara përfundimit të mandatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni publikon shpalljen për vendin vakant të Inspektorit të Përgjithshëm.
4. Në rastet e mbarimit të mandatit sipas nenit 14 të këtij ligji, shpallja për vendin vakant të Inspektorit të Përgjithshëm bëhet kryesisht nga Kuvendi, brenda 10 ditëve nga krijimi i vakancës.
5. Çdo shtetas, i cili plotëson kushtet e nenit 12 të këtij ligji mund të paraqesë në Kuvend kandidaturën për Inspektor të Përgjithshëm. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin përkatës, që provon përmbushjen e kushteve ligjore dhe kriterëve objektive.
6. Lista e kandidatëve i kalon komisionit të përhershëm të Kuvendit që mbulon çështjet ligjore për të verifikuar përmbushjen e kriterëve dhe kushteve përkatëse. Komisioni shqyrton kandidaturat dhe zbaton procedurat në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Komisioni përzgjedh të paktën dy kandidatë sipas procedurës së mësipërme, të cilët i kalojnë Kuvendit për votim.
7. Kuvendi zgjedh Inspektorin e Përgjithshëm me 3/5 e anëtarëve të tij në votimin e parë. Në rast se kjo shumicë votash nuk arrihet, Kuvendi zhvillon votimin e dytë jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi pa sukses i votimit të parë. Në votimin e dytë, Kuvendi zgjedh Inspektorin e Përgjithshëm me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.
8. Inspektori i Përgjithshëm bën deklarin e parë të pasurisë brenda 30 ditëve nga zgjedhja e tij dhe çdo vit, sipas nenit 4 të këtij ligji, pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
9. Pas përfundimit të mandatit, me pëlqimin e tij, ai ka të drejtë të emërohet në funksionin ose detyrën publike që kishte para zgjedhjes së tij ose në një vend të barasvlefshëm me vendin e mëparshëm. Ai nuk përfiton nga kjo e drejtë, në rastet kur shkarkohet për shkelje të rëndë të ligjit ose për akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Inspektorit të Përgjithshëm.”

Neni 7

Në nenin 15, pika 1, shkronja “a/1” ndryshohet si më poshtë:

“a/1. Drejton Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në zbatim të legjislacionit në fuqi për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.”

Neni 8

Në nenin 17, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) mbledh të dhëna, kryen hetime dhe kërkime administrative rreth deklarimeve të personave që kanë detyrimin për deklarim, sipas këtij ligji, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Mbledhja e të dhënave bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar”.

Neni 9

Në nenin 25/1, pika 5 ndryshohet si mëposhtë:

“5. Kontrolli i plotë dhe hetimi administrativ i kryer nga Inspektorati i Lartë përfundon brenda 6 muajve pas fillimit të tij, i cili mund të zgjatet nëpërputhje me kërkesat e Kodit të Procedurave Administrative”.

Neni 10

Në paragrafin e katërt të nenit 26, pas fjalëve “Inspektorit të Përgjithshëm,” shtohen fjalët “apo inspektorëve të autorizuar prej tij”.

Neni 11

Në Nenin 40, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Procedurat për zbatimin e masave administrative dhe ankimin ndaj tyre rregullohen sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe dispozitave të legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative”.

Neni 12

Në nenin 42/1 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 3, 4, 5 ndryshohen si më poshtë:

“3. Për efekt të deklarimit të dërguar me mjete të komunikimit elektronik, sipas nenit 4/2 të ligjit, zbatimi i tij kryhet me përgatitjen dhe vënien në dispozicion të infrastrukturës së nevojshme nga Inspektorati i Lartë. Deri në momentin e funksionimit të sistemit elektronik, subjektet e këtij ligji dhe personat e lidhur mbartin detyrimin për të paraqitur deklaratën e interesave privatë, në formë shkresore dhe të mbyllur në zarf, në strukturat përkatëse të institucioneve.

4. Për efekt të sigurimit të të dhënave dhe informacionit, sipas nenit 26 të ligjit, zbatimi i tij kryhet me përgatitjen dhe vënien në dispozicion të infrastrukturës së nevojshme nga Inspektorati i Lartë.

5. Për efekt të publikimit të deklaratave të interesave privatë, sipas pikës 2, të nenit 34 të ligjit, zbatimi i tij kryhet me përgatitjen dhe vënien në funksionim të infrastrukturës së nevojshme nga Inspektorati i Lartë.”

2. Në pikën 7, togfjalëshi “pa të drejtë rizgjedhjeje” hiqet.

Neni 13

Pas nenin 42/1 shtohet neni 42/2 me përmbajtjen si më poshtë:

“Neni 42/2

1. Për efekt të deklarimit të interesave private të dërguar me mjete të komunikimit elektronik, sipas nenit 4/2 të ligjit, të gjithë zyrtarët dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrimin për deklarim, detyrohen të deklarojnë:

- a) Në deklarimin periodik vjetor, gjendjen e pasurisë së grumbulluar, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë burimet e krijimit të tyre, në 31 dhjetor të vitit të deklarimit.
- b) Në deklarimin para fillimit të punës, gjendjen e pasurisë së grumbulluar, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë private të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë burimet e krijimit të tyre, në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit.
- c) Në deklarimin pas largimit nga funksioni, gjendjen e pasurisë së grumbulluar, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë private të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë burimet e krijimit të tyre, në datën e largimit nga funksioni.

2. Parashikimet në shkronjat a) dhe c) janë të vlefshme vetëm për plotësimin për herë të parë të deklaratës së interesave private nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik.

3. Inspektori i Përgjithshëm, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, merr të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kësaj pike”.

Neni 14

Dispozitë kalimtare

Në rast mospërputhjes midis të dhënave të deklaruara në deklaratën e dërguar me mjete të komunikimit elektronik dhe të dhënave të deklaruara në deklaratimet e mëparshme, përpara funksionimit të sistemit elektronik sipas parashikimeve të nenit 42/1, pika 3 të këtij ligji, do të mbizotërojnë të dhënat që janë në favor të zyrtarit dhe personave të tjerë të lidhur, që mbartin detyrimin për deklarim.

Neni 15

Hyrja në Fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI

